

## KALLËZIM PENAL

**KALLZUES:** Drejtuesi Politik i Partisë Demokratike Qarkut Korçë, Edmond Spaho, me adresë Selia e Partisë Demokratike Korçë.

**ME OBJEKT:** Kallëzim i veprës penale

- "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", parashikuar nga neni 328 të Kodit Penal.
- Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushirojnë funksione publike" parashikuar nga neni 245/1 të Kodit Penal.

**KUNDËR:** [REDAKTUAR]

**DREJTUAR:** STRUKTURES SE POSACME KUNDER KORRUPSIONIT DHE  
KRIMIT TE ORGANIZUAR " SPAK "

Rr: "Jordan Misja" Nr.1 TIRANE

---

Kallzuesi, Edmond Spaho, Drejtues Politik i Partisë Demokratike Qarkut Korçë, bazuar në nenin 328 dhe 245/1 të K.Penal parashtron këtë kallzim penal për veprën penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

*Neni 328*

*Ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën veprën penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në pesë vjet.*